

V E N D I M
Nr.2, datë 7.1.1999

PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT, TË SHKENCËS DHE KULTURËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për bashkëpunimin në fushat e arimit, të shkencës dhe kulturës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko